

**20240831683**

Sipas nenit 77, paragrafi (11) dhe (12), 77-z, paragrafi (3) dhe 77-j, paragrafi (2) të Ligjit të Sigurimit të Detyrueshëm Pensional të Financuar me Kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018, 245/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 180/2019 dhe 103/2021), Këshilli i ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional, në seancën e mbajtur më 28.3.2024, miratoi

**RREGULLORE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR  
AGJENTË TË SHOQËRIVE PENSIONALE**

Neni 1

Në Rregulloren për Agjentë të Shoqërive Pensionale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 110/2016 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 184/2019 dhe 268/2023) neni 3, paragrafi (4) ndryshohet dhe bëhet:

“Dëshmitë për plotësimin e kushteve për dhënien e provimit për agjentë, duhet të skanohen ose nënshkruhen me nënshkrim elektronik, të jenë të lexueshëm në gjuhën maqedonase ose të përkthyer nga përkthyes të autorizuar gjyqësor”.

Paragrafi (5) fshihet.

Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 01-490/3  
1.4.2024  
Shkup

Kryetari i  
Këshillit të Ekspertëve,  
**Максуд Али, с.р.**